



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3480 Prot

Vlorë, më 21.03 2023

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e këshillit të bashkisë, datë 31 mars 2023.

**ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË**

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORË**

**PREFEKTIT TË QARKUT VLORË**

Ju njoftoj se, **ditën e premte , datë 31.03.2023, ora 10:00**, në pallatin e kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryetarja e këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4, me këtë

**REND DITE :**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë , datë 24.02.2023 .
2. Miratimi i projektvendimit “ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin shkurt 2023”.
3. Miratimi i projektvendimit “ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondit i kushtëzuar për muajin shkurt 2023”.
4. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve me probleme të thella social ekonomike, që do të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë për një periudhë 10-mujore, me të ardhurat e bashkisë”.
5. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë

për çdo rast”.

- 6.Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e tavanëve përgatitorë të të ardhurave për Program Buxhetin Afatmesëm 2024-2026”.
- 7.Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e tavanëve përgatitorë për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.
- 8.Miratimi i projektvendimit “ Mbi miratimin e Buxhetit Faktit të vitit 2022”.(Buxheti i Pavarur, i Pakushtëzuar, Specifik, i Kushtëzuar).
- 9.Miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 1 datë 18.01.2023 “Për buxhetin e bashkisë për vitin 2022”.
- 10.Miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve, Bashkia Vlorë”.
- 11.Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e mënyrës së realizimit dhe fondit financiar vjetor shtesë , të shërbimit të pastrimit për qytetin e Vlorës dhe njësitë administrative “.
- 12.Seancë informuese për ndryshimet klimaterike dhe situatat mjedisore në territorin e Bashkisë Vlorë.

**Konferenca e Kryetarëve**, do të zhvillojë mbledhjen, **ditën e enjte**, datë **30.03.2023**, në mjediset e bashkisë Vlorë, në orën **09:00**.

**Komisionet** e përhershme do të mbledhen po në mjediset e bashkisë Vlorë, si më poshtë :  
Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike do të mbledhet **ditën e enjte** , datë **30.03.2023**, ora 10.00.

**Komisioni i ekonomisë, financave dhe privatizimeve**, do të mbledhet **ditën e enjte**, datë **30.03.2023**, ora 11.00.

**Komisioni i shërbimeve publike,transportit dhe strehimit**, do të mbledhet **ditën e enjte**, datë **30.03.2023**, ora 12.00.

**KRYETARE**

**Migena Balla**

